



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. 7681 Prot.,

Lezhë, më 21.05.2026

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, në ligjin nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Urdhërit nr. 136 datë 16.02.2026 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimin e pozicioneve, klasat për çdo pozicion punë për administratën e bashkisë, të njësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njësive të shërbimeve për vitin 2026”, Vendimit nr.15 datë 25.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për miratimin e nivelit të pagave të administratës së bashkisë, të njësive administrative, të punonjësve të varësisë, të punonjësve të njësive mbështetëse, të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave”, i ndryshuar, Bashkia Lezhë njofton për shpalljen e procedurave për vende të lira pune për pozicionet:

- **Punonjës Sezonal (Info Point) – 4 pozicione**
- **Punëtor Shërbimesh sezonal me kontratë – 30 pozicione**

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Punonjës Sezonal (Info Point) është:

- Merret me promovimin e turizmit.
- Bashkëpunon me aktore të tjerë të turizmit për përmirësimin e shërbimeve, mirëmbajtjen dhe pasurimin e infrastrukturës së nevojshme.
- Identifikon, siguron dhe mban kontakte të vazhdueshme me operator turistik që kanë aktivitet në territorin e Lezhës, për të mundësuar donacione në shërbim të turizmit.
- Identifikon dhe mban kontakte të vazhdueshme me Agjensi turistike kombëtare dhe ndërkombetare për përfshirjen e Lezhës në itineraret e tyre.
- Të identifikojë, sigurojë kontakte dhe bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me të gjitha operatorët turistike që kanë aktivitet në Bashkinë e Lezhës dhe agjencitë e ndryshme turistike në shërbim të përmirësimit të turizmit.
- Kordinon punën me Bashkinë Lezhë, Drejtorinë e Turizmit dhe Njësinë Administrative Shëngjin për krijimin e kushteve të favorshme për zhvillimin e turizmit dhe kërkon marrjen e masave për zgjidhjen e problemeve që shfaqen.

- Mban të dhëna statistikore.
- Raporton një herë në javë te Drejtoria e Turizmit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin pranë Sportelit të Zyrës me një Ndalesë në Bashkinë Lezhë si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar,
- b- Fotokopje të diplomës e noterizuar,
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë),
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID),
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore,
- f- Dëshminë e Penalitetit,
- g- Çertifikata Personale,
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 01.06.2026.

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Punëtor Shërbimesh sezonal me kontratë është:

- Përgjigjet për mirëmbajtjen e stacioneve të plazhit dhe të çadrave.
- Qëndron në gatishmëri të plotë për të ndërhyrë për mbajtjen në funksionim të plotë të paisjeve/mjeteve të punës.
- Të raportojë tek mbikëqyrësi për detyrën e kryera.
- Zbaton parimet e punës në grup.
- Pastron vendin dhe mjetet e punës pas mbarimit të punës.
- Planifikon kërkesat për materiale për riparimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe ambjenteve të dëmtuara.

- Të njohë rregullat e sigurimit teknik gjatë punës dhe mbrojtjen kundra zjarrit në vendin e tij të punës.
- Zbaton rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin pranë Sportelit të Zyrës me një Ndalesë në Bashkinë Lezhë si më poshtë:

- f- Jetëshkrim i plotësuar,
- g- Fotokopje të diplomës e noterizuar,
- h- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë),
- i- Fotokopje të letërnjoftimit (ID),
- j- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore,
- k- Dëshminë e Penalitetit,
- l- Çertifikata Personale,
- m- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë ose drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 01.06.2026.

Rezultatet për fazën e verifikimit

Pas verifikimit të dokumentacionit, Bashkia Lezhë do të shpallë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të kërkuara si më sipër. Kandidatët e kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohen, për tu paraqitur pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

KRYETARI
Pjerin Ndreu

